



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

Ofruesi i Shërbimeve Programore RTK 3-NEWS
Transmetuesi Publik – sipas Ligjit Nr 04/L-046

Mentor Shala
Drejtor i Përgjithshëm
Rr/Xhemail Prishtina nr. 12
Prishtinë

VENDIMI: LIC/KPM-2013/27
Ref:1306/748/KPM/ni

VENDIM

lidhur me licencimin e ofruesit të shërbimeve programore “RTK 3-NEWS” – Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të Ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat i nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për Distribuimin Kabllor të Programeve Radiotelevizive në Kosovë (CIMC 2007/04), ka hyrë në fuqi më 06.07.2007. Ndërsa, në bazë të Nenit 16 të Rregullores CIMC 2007/04, KPM-ja ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Programore, të cilët do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtjesore të cilat programe do të mund të transmetohen vetëm nëpërmjet operatorëve kabllorë.
3. Kandidati për Ofrues të Shërbimeve Programore “RTK 3-NEWS”, ka dorëzuar aplikacionin e plotësuar për Licencë të KPM-së, me datën 15 maj 2013.

Arsvetim

4. Në bazë të nenit 16.4 të Rregullores 2007/04, Ofruesit e Shërbimeve Programore do të rregullohen sikurse subjekte transmetuese.
5. Kandidati për licencë të KPM-së “RTK 3-NEWS”, në aplikacionin e tij ka paraqitur të dhëna për Licencë të KPM-së, për të ofruar shërbime programore dhe në pajtueshmëri me Nenin 16 të Rregullës CIMC 2007/04, Ofruesi i Shërbimeve Programore “RTK 3-NEWS” ka paraqitur të gjitha të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së.
6. Komisioni i Pavarur për Media, vlerëson se kandidati “RTK 3-NEWS” ka ofruar informacione të mjaftueshme për vlerësim të aplikacionit. Informacionet e ofruara, mund

të konsiderohen si informacione bindëse lidhur me skemën programore në përgjithësi, duke paraqitur një strukturë të qartë organizative, informacione rreth aftësive profesionale dhe menaxheriale për të udhëhequr me ofrues të shërbimeve programore.

7. Në pajtim me nenin 16.4, të Rregullores 2007/04, Ofruesit e Shërbimeve Programore "RTK 3-NEWS", duhet të veprojë në pajtueshmëri me të gjitha rregullat dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM, në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, si dhe me ligjet tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
8. KPM-ja vlerëson se Ofruesi i Shërbimeve Programore "RTK 3-NEWS" ka përmbushur kriteret për kualifikim për licencë të KPM-së.

Vendim

9. Komisioni, konkludon se kandidati "RTK 3-NEWS" ka aplikuar për licencë të KPM-së dhe ka ofruar të gjitha të dhënat e nevojshme për të ofruar shërbime të programeve nëpërmjet sistemit kabllor.
10. Komisioni, vendosë që kandidatit RTK 3-NEWS" me seli në Prishtinë, t'i lëshojë licencën për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Programore në Republikën e Kosovës.
11. Në bazë të Nenit 3.2, të Rregullores për Distribuim Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë, licenca për "RTK 3-NEWS" do të jetë valide për një periudhë prej dhjetë (10) vitesh, me mundësi vazhdimi nga ana e KPM-së.
12. Në pajtueshmëri me Nenin 5.1, të Rregullores për nivelin dhe mënyrën e pagesës së taksës së licencës për shërbimet mediave audio-vizuale (KKPM-2010/02), çdo Ofrues i Shërbimeve Programore duhet të paguajë taksë vjetore. Niveli i taksës vjetore për licencë të OSHP është i përcaktuar me Nenin 4.3.1. të Rregullores KKPM 2010/02.
13. Në pajtueshmëri me Rregulloren KKPM-2010/02, përkatësisht me nenin 5.2 të kësaj rregulloreje, Ofruesi i Shërbimeve Programore "RTK 3-NEWS", duhet ta paguajë taksën e parë vjetore për licencë jo më vonë se 14 ditë pas pranimit të vendimit për licencim.
14. Ofruesi i Shërbimeve Programore "RTK 3-NEWS" mund të fillojë transmetimin e programit vetëm pas nënshkrimit të Pakos së Licencës së KPM-së.

Lëshimi i Vendimit

15. Këtë vendim e lëshon Komisioni i Pavarur për Media dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit.



Shefki Ukaj
Kryetar
Komisioni i Pavarur për Media



6. Zershor 2013
datë